

## TË DHËNAT TEKNIKE

**Lloji:** Astar epoksid për dysHEME me baze uji

**Komponentet:** 2 - A (Astari epoksid) B (Agjent ngurtësues)

**Ngjyra:** Transparente.

**Raporti i përzierjes:** 3kg (Komponenti A) ; 1kg (Komponenti B (3:1)

**Hollimi:** Produkti mund të hollohet me uje deri në 50% të peshës totale të përzierjes ose e paholluar në rastet kur do perdoret si shtrese finale transparente.

**Koha e tharjes:** 8 orë (në 20°C dhe 65% lagështi relative) në prekje për doren e pare.

**Viskoziteti:** 70 KU (në 25°C)

**Pesha Specifike:** 1.2 gr/cm³

**Hapja:** 14-15 m²/kg (A+B+50% UJE)

**pH:** 8

**Gloss (60°):** Gloss

**Rezistenca në ngjitje:**  $\geq 2,0 \text{ N/mm}^2$  (sipas ISO 4624)

**Pershkueshmeria nga avujt e ujit:**  $\text{SD} \leq 5 \text{ m}$  (EN ISO 7783)

**Rezistencë ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve:** Shumë e lartë.

**Temperatura minimale e aplikimit:** +10°C.

**Temperatura maksimale e aplikimit:** +30°C.

**PINTOCOLOR**  
TUTTI I MIEI COLORI



Dëshironi të dini më shumë mbi produktet tona?  
Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5.  
🌐 [www.dekoll.al](http://www.dekoll.al) | 📞 +355 69 606 6656 | ✉ [info@dekoll.al](mailto:info@dekoll.al)

**PINTOCOLOR**  
TUTTI I MIEI COLORI

**EPOX PRIMER 2K**



## PËRSHKRIMI

EPOX-PRIMER 2K është Astar epoksid për dysheme me bazë uji, 2-komponentësh, me një formulim të avancuar për përgatitjen dhe mbrojtjen e dyshemeve industriale dhe komerciale. Ka një perfundim estetik, të pastër transparent dhe rezistent ndaj larjeve të shpeshta. EPOX-PRIMER 2K ofron një shtresë të qëndrueshme, të fortë, të pastër dhe miqësore me ambientin duke mbrojtur sipërfaqet kundër dëmtimeve mekanike, kimike dhe ndikimeve të tjera mjedisore. Ka një rezistencë të lartë ndaj solventeve alifatike, naftes, vajerave minerale, benzines apo detergjenteve. Rezistencë e lartë mekanike ndaj gërvishtjeve, dëmtimeve dhe abrazionit.

## PËRGATITJA E SUPORTIT

Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e pastër, e thatë dhe pa pluhur, yndyrë ose mbetje të tjera që mund të ndikojnë në ngjitjen e bojës. Nëse suporti është shumë i lëmuar sugjerohet që të zmerilohet me leter zmerile dhe me pas të pastrohet nga pluhurat e krijuar, në mënyrë që të krijohet një ngjitje sa më e mirë e astarit me suportin. Nëse është e nevojshme, pastroni sipërfaqen me një pastrues të përshtatshëm (tretesire acide 10%). Duhet të pastrohet me pas sipërfaqja mirë me ujë për të eliminuar mbetjet e tretesirës acide. Nëse suporti ka defekte apo plasritje në dysheme, duhet të bëhet riparimi i tyre përpara aplikimit të astarit.

## PËRGATITJA E PRODUKTIT

Shtoni komponentin B në komponentin A në raportin e dhënë dhe perzieni mirë tretesirën me një mikser me xhiro të uletë për rreth 5 minuta që të arrihet një masë homogjene. Pas perzierjes lëreni tretesirën në qetësi për 5 minuta në mënyrë që të sigurohemi që ka nisur reaksioni i induksionit. Pas kohës së pritjes bëjmë hollimin me ujë të perzierjes, deri në 50%. Produkti është me pas i gatshëm për aplikim. Në rastet kur EPOX-PRIMER 2K përdoret si shtresë finale transparente bëhet një aplikim 2-3 duar ku dora e parë aplikohet e holluar 50% (si astar) ndërsa dora e dytë aplikohet e paholluar.

## APLIKIMI

Përdorni një rrul, penel ose spatul për aplikimin e EPOX-PRIMER 2K. Sigurohuni që sipërfaqja e dyshemesë të jetë e pastër dhe e thatë para aplikimit. Për të arritur mbulimin maksimal, mund të aplikoni disa shtresa të holla, duke pritur tharjen e plote ndërmjet secilës shtresë.

